



REPUBLIKA E KOSOVËS	Rëpublika Kosovë • Republic of Kosovo
INSTITUCIONI I AVOKATIT TË POPULLIT	Institucioni i Ombudsmanit • Ombudsperson Institution
Nr/Br/No.	<u>45112022</u>
Nr i foljur/Br/No pg.	<u>25103122</u>
Date/Datum/Date:	



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT

I

AVOKATIT TË POPULLIT

A. nr. 703/2020
Shemsije Ahmeti

në lidhje me zvarritjen e procedurës në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës në lëndën C-IV-13-0964

Drejtuar: Z. Ilmi Bajrami, gjyqtar mbikëqyrës
Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme e Kosovës

Prishtinë, më 25 mars 2022

Qëllimi i reportit

1. Ky rapport është i bazuar në ankesën e znj. Shemsije Ahmeti (në tekstin e mëtejmë: ankuesja) dhe ka për qëllim që t’ia adresojë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK) konstatimet lidhur me shkeljen e të drejtave të njeriut dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit lidhur me çështjen e ngritur nga ankuesja.

Baza ligjore

1. Sipas nenit 135, paragafi 3, të Kushtetutës: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”
2. Po ashtu, Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 16, paragafi 8, përcakton: “Avokati i Popullit mund të jep rekomandime të përgjithshme përfunksionimin e sistemit gjyqësor. Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe në procedura tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përvèç rastit kur ka zvarritje të procedurave.”

Rrethanat e rastit

3. Më 24 qershor 2013, ankuesja kishte parashtruar ankesë në DhPGjSK kundër Vendimit nr. PRZ006 – 0023 të AKP-së, nr. prot. 123, datë 5 qershor 2013, me të cilin i ishte refuzuar kërkesa për kompensimin e pagave të papaguara përfashëshortin e saj të ndjerë, në shumën bruto prej 1.170.28 eurosh.
4. Më tej, më 2 dhjetor 2020, ankuesja kishte paraqitur ankesë te Avokati i Popullit, për shkak të zvarritjeve procedurale përfundosjen në lëndën C – IV – 13- 0964, nga DhPGjSK-ja.
5. Më 17 dhjetor 2021, Avokati i Popullit i ka dërguar shkresë ushtruesit të detyrës së gjyqtarit mbikëqyrës të DhPGjSK-së dhe ka kërkuar informacione lidhur me veprimet që i ka ndërmarrë dhe për ato që planifikon t’i ndërmarrë kjo gjykatë përkitazi me trajtimin e çështjes, duke marrë parasysh edhe faktin se nga paraqitja e ankesës kanë kaluar më tepër se tetë vjet.
6. Më 29 dhjetor 2021, DhPGjSK-ja ka kthyer përgjigje dhe ka njoftuar se, më 17 janar 2021, kjo gjykatë kishte nxjerrë aktvendim me të cilin ishte ndërprerë procedura gjyqësore. Më tej, nga DhPGjSK-ja kanë njoftuar se këtë aktvendim ankuesja e kishte pranuar më 12 shkurt 2021.
7. Avokati i Popullit mëson se, më 17 janar 2021, DhPGjSK-ja kishte nxjerrë aktvendim me të cilin ishte ndërprerë procedura përfshak të vdekjes së bashkëshortit të ankueses. Më tej, në aktvendim specifikohet se procedura e ndërprerë do të vazhdohej kur trashëgimtarët e të ndjerit të kérkonin vazhdimin, [...], apo kur gjykata në bazë të propozimit të palës së kundërt kérkon që palët ta vazhdojnë procedurën.
8. Nga të dhënët e rastit mësohet se procedura pranë DhPGjSK ishte iniciuar nga ankuesja, pas vdekjes së bashkëshortit, ndërsa DhPGjSK nuk kishte vlerësuar legjitimitetin aktiv të palës, në këtë rast ankueses dhe se këtë e ka bërë 8 vite më vonë me anë të aktvendimit të sipërpërmendur.
9. Ankuesja e ka njoftuar Avokatin e Popullit se pas zhvillimit të procedurës trashëgimore më 13 prill 2021 GjThPz - Dega në Suharekë kishte nxjerrë Aktvendim me të cilin i ka njohur si trashëgimtarë ankuesen dhe fëmijët e saj. Më tej, ankuesja ka njoftuar se më 14

prill 2021, ajo e ka dorëzuar në DhPGjSK aktvendimin mbi trashëgiminë së bashku me kërkesën për vazhdim të procedurës.

10. Megjithatë edhe pas dërgimit të Aktvendimit për trashëgiminë si dhe Kërkesës për vazhdimin e procedurës në DhPGjSK, sipas ankueses, DhPGjSK akoma nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim për procedimin e rastit.

Instrumentet ligjore të zbatueshme në Republikën e Kosovës

11. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 21, përcakton: “*Republika e Kosovës mbrojnë dhe garanton të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, [...].*”

12. E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm përcaktohet me nenin 31.1 të Kushtetutës: “*Çdo kujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*”

13. Po ashtu, mbrojtja gjyqësore e të drejtave, në nenin 54 të Kushtetutës, përcakton:

“*Çdo kush gjzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutë ose më ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.*”

14. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNj) është e zbatueshme drejtëpërdrejt në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe, në rast konflikti, ka prioritet ndaj dispozitave, ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.¹ Paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNj-së përcakton: “*Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile, çdo njëri ka të drejtë për një proces të drejtë dhe të hapur brenda një afati të arsyeshëm kohor.*”

15. Ligji nr. 06/L-086 për Dhomën e Posacmë të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, në nenin 3, paragrafi 3, përcakton: “*Dhoma e Posacmë është pjesë e Gjykatës Supreme të Kosovës, siç përcaktohet me Ligjin për Gjykatat dhe funksionon në kuadër të organizimit të brendshëm të kësaj gjykate.*”

16. Ligji nr. 03/L-199 për Gjykatat, në nenin 7, paragrafi 2, përcakton: “*Çdo person ka qasje të barabartë në gjykata dhe askujt nuk i mohohet e drejta në gjykim të drejtë në përputhje me procedurën e rregullt ligjore ose të drejtë në mbrojtje të barabartë me ligj. Çdo person fizik apo juridik ka të drejtë në gjykim të drejtë dhe brenda afatit të arsyeshëm kohor.*”

17. Ndërsa nen 7, paragrafi 5, i Ligjit nr. 03/L-199 për Gjykatat përcakton: “*Të gjitha gjykatat duhet të funksionojnë në mënyrë të shpejtë dhe efikase për të siguruar zgjidhjen e shpejtë të lëndëve.*”

Analiza ligjore dhe konstatimet e Avokatit të Popullit

18. Zvarritje e procedurës në DhPGjSK përbën shkelje të së drejtës për proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm kohor, i garantuar me paragafin 1 të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, i cili thotë: “*Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile [...], çdo njëri ka të drejtë për një proces të drejtë dhe të hapur brenda një afati të arsyeshëm [...].*”

¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, nen 22.

19. Sipas nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj).
20. GjEDNj-ja ka vlerësuar se e drejta e palës që për çështjen e tij të vendoset brenda një afati të arsyeshëm kohor paraqet element qenësor të së drejtës përgjegjësi e gjykatës dhe të paanshëm.
21. Avokati i Popullit rikujton se GjEDNj-ja ka vërtetuar se zgjatja e procedurës normalisht llogaritet nga koha e inicimit të procedurave gjyqësore (shih aktgjykimin: *Moldovan dhe të tjerët kundër Rumanisë*, më 12 korrik 2005; dhe aktgjykimin: *Sienkieëicz kundër Polonisë*, më 30 shtator 2003) deri në kohën kur çështja ka përfunduar dhe/ose aktgjyki i është ekzekutuar (shih aktgjykimin *Poitier kundër Francës*, më 8 nëntor 2005).
22. Avokati i Popullit vëren se GjEDNj-ja, në rastin *Zimmermann dhe Steiner kundër Zvicerës*, ka theksuar se një prej faktorëve që duhet të merret në konsideratë është sjellja e autoriteteve kompetente gjyqësore dhe administrative dhe se është përgjegjësi e gjykatës që ta organizojë punën e saj në atë mënyrë që individët të informohen për përparimin dhe rezultatet mbi çështjet e tyre, brenda një kohë të arsyeshme (aktgjykim *Zimmermann dhe Steiner kundër Zvicerës*, 13 korrik 1983).
23. Në rastin në fjalë, Avokati i Popullit rithekson se periudha përkatëse për t'u shqyrtauar lënda e ankueses fillon prej datës 24 qershor 2013, datë kur ankuesja kishte paraqitur ankesë në DhPGjSK dhe se procedurat lidhur me rastin deri më tanë zgjatur mbi tetë vjet. Prandaj, Avokati i Popullit vlerëson se ka shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNj-së në kuptim të së drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor.
24. Në anën tjetër, mungesa e mjeteve efektive lidhur me shkeljen e së drejtës për proces të rregullt brenda një afati të arsyeshme, siç është e garantuar me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përbën shkelje të nenit 13 të Konventës, i cili thotë: “*Çdo person, të cilat i kanë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura me këtë Konventë, ka të drejtë të parasesë një ankim efektiv përpëra një instance kombëtare, edhe kur kjo shkelje ka qenë kryer nga persona që veprojnë brenda ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare.*”
25. Sa i përket zbatimit të nenit 13 të Konventës, Avokati i Popullit rikujton se GjEDNj-ja disa herë e ka theksuar se vonesat e mëdha në administrimin e drejtësisë lidhur me palët kontestuese, të cilat nuk kanë mjete, përbëjnë kërcënim për sundimin e ligjit brenda rendit vendor ligjor (shih aktgjykimin në rastin *Bottazi kundër Italisë*, më 28 korrik 1999; dhe aktgjykimin në rastin *Di Mauro kundër Italisë*, më 28 korrik 1999). Avokati i Popullit gjithashtu rikujton se edhe pse GjEDNj-ja ka vendosur se mjetet efektive do të duhej të interpretoheshin në atë mënyrë që të kuptohej se mjetet mund të janë efektive në kuptim të spektrit të kufizuar të një mjeti efektiv brenda një konteksti të veçantë (aktgjykimi në rastin *Klass dhe të tjerët kundër Gjermanisë*, më 6 shtator 1978), GjEDNj-ja gjithashtu ka vendosur edhe si vijon:
- “*Për sa i përket dështimit të pohuar për të siguruar seancë gjyqësore brenda një afati të arsyeshëm [...] asnjë kualifikim i tillë i përbajtur në fushën e nenit 13 nuk mund të dallohet. Në të kundërtën, vendi i nenit 13 në skemën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut të paraparë me Konventë do të përkrahte mbajtjen në minimum të kufizimeve të*

nënkuptuara me nenin 13 (aktgjyki i mënyrës së drejtës së ankesës, më 26 tetor 2000). ”

26. Në vend të kësaj, neni 13 pasqyron në mënyrë të drejtpërdrejtë obligimin e shtetit që fillimisht dhe në mënyrë primare t'i mbrojë të drejtat e njeriut nëpërmjet sistemit të tij ligjor duke vendosur me këtë rast një garanci shtesë për një individ për të siguruar që ai apo ajo gjëzon të drejtat në mënyrë efektive. Nëse shikohet nga kjo perspektivë, e drejta e një individi për proces të rregullt brenda një kohe të arsyeshme do të jetë më pak efikase nëse nuk ekziston mundësia që së pari ta parashtrojë këtë ankesë te një autoritet vendor. Kërkesat e nenit 13 përkrahin ato të nenit 6 (shih aktgjykimin e lartpërmendor *Kudla*). Kështu, neni 13 garanton një mjet ankimi efektiv në një autoritet vendor për një shkelje të pohuar të kërkesave të nenit 6 për ta shqyrta rast brenda një kohe të arsyeshme. Pasi rasti në fjalë ka të bëjë me ankesën lidhur me kohëzgjatjen e procedurës, neni 13 i Konventës është i zbatueshëm.
27. Lidhur me kërkesat e nenit 13, Avokati i Popullit rikujton se efekti i këtij neni është që të kërkojë që një dispozitë e një mjeti vendor të merret me substancën e “një ankesë të kontestueshme” sipas Konventës dhe të lejojë lehtësimin përkatës (shih p.sh. aktgjykimi në rastin *Kaya kundër Turqisë*, më 19 shkurt 1998). Çfarëdo mjeti i tillë duhet të jetë efektiv si në praktikë ashtu edhe në ligj (shih p.sh. aktgjykimi në rastin *Ilhan kundër Turqisë*, më 27 qershor 2000). Lidhur me ankesën për zvarritje të procedurës, Avokati i Popullit rikujton se “mjetet efektive” në kuptim të nenit 13 do të duhej të ishin në gjendje ta parandalonin shkeljen e pohuar ose ta parandalonin vazhdimin e saj, ose për të ofruar përmirësimin adekuat për çfarëdo shkelje që kishte ndodhur (shih aktgjykimin e lartpërmendor *Kudla*).
28. Avokati i Popullit vëren se, megjithëse çështja është ngritur disa herë te autoritetet kompetente, por asnjë mënyrë specifike ligjore nuk ka ekzistuar në çështjen në fjalë, përmes së cilës ankuesja do të mundë të ankohej për zvarritje të procedurës me çfarëdo parashikimi apo shprese për ta arritur çfarëdo lehtësimi në formë të parandalimit apo kompensimit.
29. Prandaj Avokati i Popullit nxjerr përfundimin se ka pasur shkelje të së drejtës së ankuesit për ankimi efektiv, i garantuar me nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Prandaj Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës “[...] *Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore*”; dhe me nenin 16, paragrafi 8, të Ligjit për Avokatin e Popullit, sipas të cilit: “*Avokati i Popullit mund të jap rekomandime të përgjithshme përfunksionimin e sistemit gjyqësorë. Avokati i Popullit nuk do të ndërhynë në rastet dhe procedurat tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përveç rastit kur ka zvarritje të procedurës*”, bazuar në analizën ligjore të mësipërme, në cilësinë e rekomanduesit, duke iu referuar argumenteve të lartpërmendura, me qëllim të përmirësimit të punës në sistemin gjyqësor të Kosovës, i

REKOMANDON

Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës:

- Pa vonesa të mëtutjeshme, t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për shqyrtimin dhe vendosjen e lëndës C-IV-13-0964.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“*Cdo organ, institucion ose autoritet tjeter, që ushtron pushtet legitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuar në pajtim me ligj*”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“*Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, (...) duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë*”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.


Me ndërime,
Naim Qelaj
Avokat i Popullit